



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT KORÇË

VENDIM

Nr. 9 date 12.02.2008

Për zgjedhjen e UKKO si agjent tatimor për pagesën e “Tarifave dhe taksave vendore” nga familjarët

Këshilli Bashkiak i mbledhur sot në datë 12.02.2008 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e të Ardhurave në mbështetje të nenit 32 të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore” i ndryshuar, në nenin 5 gërma c/ii, të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” të ndryshuar, në bazë të të cilit Këshilli Bashkiak përcakton mënyrën e mbledhjes së taksës, përfshirë zgjedhjen e agjentit tatimor dhe detyrimet e ndërsjellta, nenin 13 të Ligjit Nr.8560 datë 22.12.1999 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në bazë të të cilit agjenti tatimor midis disa detyrimesh është i detyruar edhe të mbajë në burim tatimpaguesin dhe të transferojë në buxhet, në mënyrë korrekte dhe në kohën e duhur shumat e tatimeve dhe taksave, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.660 datë 12.09.2007 “Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellësave dhe kanalizimeve, njësive të qeverisjes vendore”

VENDOSI

- 1- Të zgjedhë agjent tatimor UKKO SHA, për pagesën e “Tarifave dhe taksave vendore” nga familjarët.
- 2- Përqindja e agjentit tatimor është zero.
- 3- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet UKKO SHA, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e të Ardhurave
- 4- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E KËSHILLIT

Rajmonda NASE

Rajmonda Nase